



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
ADMINISTRATORI

Nr.....Prot

Gjirokastrë, më _____.____.2021

NJOFTIM

PËR DOKUMENTACIONIN QË DUHET TË DORËZOJNË KATEGORITË E STUDENTËVE TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE (BACHELOR) QË PLOTËSOJNË KRITERET PËR TË PËRFITUAR BURSË SI DHE KATEGORITË E STUDENTËVE QË PLOTËSOJNË KRITERET PËR TU PËRJASHTUAR NGA TARIFA TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE (MASTER)

Bazuar në Vendimin Nr. 39, datë 23.01.2019 të Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në VKM 903, dt. 21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", të ndryshuar, Vendim nr. 40, datë 23.1.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 269, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", të ndryshuar njoftohen të gjithë studentët e ugj-së të programit të ciklit të parë bachelor dhe ciklit të dytë "Master", se ka filluar procedura për dorëzimin e dokumentave për përfitim burse për vitin akademik 2021- 2022.

1. Dorëzimi i dokumentacionit do të bëhet nëpërmjet shërbimit postar në adresën:

Universiteti "Eqrem Çabej"

Lagjia "18 Shtatori", Rruga Studenti, Gjirokastrë

kodi postar 6001

2. Dokumentacioni mund të dorëzohet edhe pranë zyrës Juridike nga e hëna në të premte, ora 09:00-12:00.
3. Bashkëlidhur gjeni formularin dhe dokumentacionin që do paraqesin studentët sipas kategorive.
4. Studentët duhet të dorëzojnë me dokumentacionin dhe nr. personal të llogarisë bankare.
5. Dokumentacioni të jetë origjinal ose i noterizuar (përveç dokumentacionit të marrë nga e-albania).

➤ **Studentët me mesatare 9 (nëntë) -10 (dhjetë)**

- Studentët e pranuar në vitin e parë akademik "Bachelor" 2020-2021 me notë mesatare 9 (nëntë) -10 (dhjetë), listat e këtyre studentëve në bazë të notës mesatare përkatëse do të përcillen nga Qendra e Shërbimeve Arsimore. Këta studentë duhet të dërgojnë me shërbimin postar vetëm fotokopje të kartës së identitetit dhe nr personal bankar.
- Studentët që ndjekin studimet, në vitet pas të parit, të cilët kanë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik, me notë mesatare vjetore e ponderuar nga 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë) përgatiten nga insitucioni (sekretaria mësimore) dhe terhiqen në formë vërtetimi pranë saj. Këta studentë duhet të dërgojnë me shërbimin postar vetëm fotokopje të kartës së identitetit dhe nr personal bankar.

Bursa financiare paguhet nga data e regjistrimit në rastet e aplikimit në fillim të vitit akademik. Për fazat e tjera, bursa financiare paguhet nga muaji pasardhës, kur studenti ka paraqitur kërkesën dhe përfitojnë vetëm ata studente që plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë vendim gjatë vitit akademik 2021 - 2022.

Bashkëngjitur shtojcat 1, 2 dhe 3.

A D M I N I S T R A T O R
S E M I G O L E M I

Gjirokastrë, më ____ / ____ / 2021

DEKLARATË

Unë _____, student në Fakultetin e _____ pranë Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë deklaroj se në të dhënat e paraqitura nga ana ime si dhe dokumentacioni shoqëruar që provon plotësimin e njërit prej kriterëve të renditura në vijim të kërkesës time, të nënvizuara me shenjën X përbri kriterit.

I gjithë dokumentacioni i paraqitur është dokumentacion zyrtar dhe i marrë nga institucione shtetërore dhe/ose të njohura me ligj.

Jam në dijeni se deklaratimet e rreme nga ana ime në këtë kërkesë, si dhe paraqitja e dokumentave të falsifikuara, përveç përgjegjësisë penale, sjellin automatikisht edhe heqjen e së drejtës për të përfituar bursë.

Vo: Dokumentat shoqëruese janë origjinale ose kopje të noterizuara.

(Emër Mbiemër, Nënshkrimi i kërkuesit)